



VENDIMËSHITË I PLOTFUQISHËM
 QILKA JË PRAVNOSNAŽNA
 GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
 FERIZAJ I UROŠEVAC

P.nr.748/2017

NË EMËR TË POPULLIT

13.10.2017

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, si gjykatë penale e shkallës së parë, gjyqtari Adem Shabani, me zyrtaren ligjore Lavdije Brahimi, në çështjen penale kundër të akuzuarit [REDACTED] me vendbanim në fshatin [REDACTED] Komuna Malishevë, për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.8 lidhur me par.6 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.297-1/15 të dt.23.03.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me dt.06.06.2017, në praninë e përfaqësuesit të akuzës prokurorit të shtetit Ismet Rrahmani, të akuzuarit [REDACTED] dhe të dëmtuari [REDACTED] të njejtën ditë mori dhe publikisht komunikoi kete:

A K T G J Y K I M

I akuzuari [REDACTED] me vendbanim në fshatin [REDACTED] Komuna Malishevë, i lindur më [REDACTED] në të njëjtin vend, nga i ati [REDACTED] dhe e ëma [REDACTED] e gjinisë [REDACTED] shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal [REDACTED] i pa denuar deri më tani, mbrohet në liri.

Ë S H T Ë F A J T O R Ë

Sespe me dt.22.02.2015, rreth orës 04:20 në magjistralen Shtime-Prizeren, duke e drejtuar automjetin e markës “ Audi ”, ngjyrë hiri, me targa të regjistrimit [REDACTED] nga pakujdesia e në kundërshtim me dispozitat e nenit 54 par.1 të LSKRR-së , ka rrezikuar trafikun publik, jetën dhe pasurinë e njerëzve, në atë mënyrë që nuk ka përshtaur shpejtësinë e lëvizjes dhe kuishteve në rrugë, ashtu që me të arritur në fshatin Carralevë Komuna Shtime afër N.T.P. “ Lulzimi ”, me të hyrë në kthesë humb kontrollin mbi automjt dhe kalon në anën e kundërt të drejtimit të lëvizjes, rrotullohet dhe bie në hendek, ku pos dëmeve material të shkakatuara në automjet, lëndime të rënda trupore pëson bashkudhëtari i tij [REDACTED] dhe atë: thyrje e kocës së krahut të djathtë, përdredhje e unazave të qafës, plagë shqyse-ndrydhëse në regjionin ballor dhe të pasme të kokës si dhe ndrydhje të indeve të buta në regjionin e kokës, të përshkruara si në ekspertizen mjeko ligjore të datës 05.03.2017,-

Me çka ka kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.8 lidhur me par.6 të KPRK-së.;

Andaj gjykata në bazë të dispozitës të sipërcituar dhe neneve 4, 7,17, 41, 42, 43, 45,46, 47, 73 dhe 74 të KPRK-së dhe nenit 365 të KPPRK-së e

G J Y K O N

Të akuzuarit [REDACTED] me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 /gjashtë/ muaj, i cili denim konform nenit 47 të KPRK-së, me pëlqimin e të akuzuarit i zëvendësohet me denim

me gjob në shum prej 500 / pesëqindë / Euro, të cilin dënim me gjobë është i obliguar ta paguan me këste për një periudhë prej katër muajsh, konform nenit 46 par.2 të KPRK-së, nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në rast se dënimi i zëvendësuar me gjobë nuk mundë të ekzekutohet në mënyra tjera të parapara në nenin 46 të KPRK-së, dënimi do të ekzekutohet në atë mënyrë që i akuzuari për çdo 20 Euro do të vuaj një ditë burgimi.

I dëmtuari [REDAKTUAR] fshati [REDAKTUAR] Komuna Drenas, për realizimin e kërkeses pasurore-juridike udhëzohet në kontest civil.

I akuzuari obligohet që në emër të shpenzimeve gjyqësore të paguaj shumën prej 60,88 € dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 30 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj, ka paraqitur aktakuzën PP/II.nr.297-1/15 të dt.23.03.2017, me të cilën ka ngarkuar të akuzuarin [REDAKTUAR], me vendbanim në fshatin [REDAKTUAR] Komuna Malishevë, për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar rreth kësaj çështje penale konform nenit 245 par.1 të KPPK-së me dt. 06.06.2017, ka mbajtur shqyrtimin fillestar në të cilin kanë marrë pjesë prokurori i shtetit Ismet Rrahmani, i akuzuari [REDAKTUAR] dhe i dëmtuari [REDAKTUAR].

Në shqyrtimin fillestar gjyqtari ka konstatuar se i akuzuari në afatin ligjor me kohë së bashku me ftesën për shqyrtim, ka pranuar edhe një kopje të aktakuzës.

Në fillim të shqyrtimit fillestar i akuzuari është udhëzuar në kuptim të nenit 246.1 të KPPK-së pastaj gjyqtari gjykues ka çmuar se të drejtat e të akuzuarit janë zbatuar, e më pas prokurori i shtetit ka lexuar akuzën ndaj të akuzuarit dhe pasi që gjyqtari është bindur se i njëjti e ka kuptuar në tërësi aktakuzën me të cilën është akuzuar, të njëjtit i ka dhënë mundësi të deklarohet mbi fajësinë apo pafajësinë e tij lidhur me veprën penale për të cilën akuzohet.

I akuzuari [REDAKTUAR] a ka theksuar se e ndien veten fajtorë dhe e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar ku në vazhdim ka deklaruar se atë ditë ishte duke drejtuar veturën e tij të markës “ Audi 100 ”, në rrugën Shtime Prizeren, me të arritur në fshatin Caralevë duke hyrë në kthesë i ishte bartur automjeti dhe kshte humbur kontrollin mbi timon ishte rrotulluar në asfalt dhe kishte dalur nga rruga dhe pastaj kishin rënë poshtë në një hendek ku bashkudhëtarë me te ishte i dëmtuari [REDAKTUAR] të cilin e ka daj dhe menjëherë pasë aksidentit ka lajmru vllaun për ndodhjen e aksidentit ku kishte ardhur dhe i ka marrur dhe

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit manifestohen të gjitha elementet e veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPRK së të cilat ndikojnë në llojinë dhe lartësinë e dënimit, si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin mori pranimin e fajësisë nga ana e të njëjtit, pendimin për veprën penale të kryer, kërkim falje të dëmtuarit të cilin e ka dajë ,që nga aksidenit për shëndetin e tij është kujdesur, hera parë që ndeshet me ligjin,i dëmtuari nuk i bashkangjitet ndekjes penale,mbajtës i familjes gjykata vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe rrezikshmerinë konkrete të kësaj vepre penale, dhe në kuptim të të gjitha këtyre, i shqiptoi me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 /gjashtë/ muaj, i cili denim konform nenit 47 të KPRK-së, me pëlqimin e të akuzuarit i zëvendësohet me denim me gjob në shum prej 500 / pesëqindë / Euro, të cilin dënim me gjobë është i obliguar ta paguan me këste për një periudhë prej katër muajsh, konform nenit 46 par.2 të KPRK-së, nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, si në dispozitiv duke qenë e bindur se një dënim i tillë është në proporcion dhe raport me peshën e veprës konkrete penale, rrethanave të kryerjes si dhe personalitetin e të akuzuarit dhe me te arrihet qëllimi ndëshkimor në kuptim të preventivës speciale që i akuzuari të mos kryejë vepra penale si dhe në kuptim të preventivës së përgjithshme të parandalimit të kësaj vepre penale në shoqëri konform nenit 41 të KPRK-së.

Konformë nenit 463 parag.1 lidhur me par 3.të KPPK-së, të dëmtuarin [REDAKTUAR] fshati [REDAKTUAR] Komuna Drenas, për realizimin e kërkeses pasuroro-juridike janë udhëzuar në kontest civil.

Konformë nenit 450 par.2.6 të KPPK-së obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve gjyqësore në shumën prej 60,88 € si dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 30 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nga sa u tha më lart është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
P nr.746/2017 me datë 06.06.2017

Zyrtarja Ligjore
Lavdiqe Brahimi

Gjyqtari
Adem Shabani

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi mundë të ushtrohet ankesë, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.